

Vlen të theksohet që në vendin tonë ka 114.503 shfrytëzues të pensionit të cilët marrin pension në shumën prej 11.863 denarë, ndërsa 65% nga numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të pensionit iu paguhet pensioni në shumën mesatare që është 15.298 denarë

Në kushte të pandemisë me Covid 19, nga ana e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, komunikimi me Shoqatat e pensionistëve realizohet në mënyrë përkatëse i përshtatur me gjendjen e imponuar nga Korona virusi. Nga komunikimi me Shoqatat e pensionistëve merren informacione që shoqatat edhe në këto kushte janë aktive në mënyrë përkatëse që të gjitha rekomandimet që i parashtrori Lidhja dhe organet kompetente i zbatojnë në mënyrë të duhur. Përveç parakushtit si t'u ndihmohet anëtarëve të saj - pensionistëve, është bashkëpunimi i pashmangshëm i Shoqatës me Komunën dhe Kryqin e kuq, në shfrytëzimin e shërbimeve të ekipeve mobile, të cilët duhet të jenë në dispozicion deri te pensionistët në Shoqatë. Shoqatat e caktuara për atë qëllim kanë të publikuar numra të telefonit për ndihmë në ueb faqet e tyre, si dhe në vende të disponueshme. Me kontaktim personal nëpërmjet telefonit me pensionistët, për të cilët shoqatat kanë evidencë që jetojnë vetë dhe atyre ju duhet ndihmë (furnizim të mjeteve të dezinfektimit dhe lloje të tjera të mjeteve) mund të përpilohen lista me të cilat do të ju ndihmohen dhe do të lidhen me ekipet.

Tashmë ashtu është në më shumë shoqata si Vevčan, Prilep, Tetovë, Çair, Ohër, Qendër dhe Gazi Babë në Shkup dhe të tjerë ku shpërndahen vauçerë, pako dhe lloje tjera të ndihmës së pensionistëve me pensione të ulëta, të cilëve iu jepen edhe shërbime në ku-

INFORMACIONET E LSHPM PËR GJENDJEN E PANDEMISË

PENSIONISTËT NGA MAQEDONIA DHE PANDEMIA



shte shtëpiake dhe jashtë shtëpisë.

Gjithashtu, një pjesë nga shoqatat realizojnë edhe aktivitete të tyre të cilat janë për respekt, dhe shembull për këtë është SHP Shtip, ku aktivitetet pensioniste në bazë vullnetare kanë bërë 2.000 maska, të cilat i kanë ndarë te pensionistët nga Shtipi. Besoj që në këtë mënyrë dhe në kufi të mundësive veprojnë edhe shoqatat tjera.

Vlen të theksohet që në vendin tonë ka 114.503 shfrytëzues të pensionit të cilët marrin pension në shumën prej 11.863 denarë, ndërsa 65% nga numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të pensionit iu paguhet pensioni në shumën mesatare që është 15.298 denarë. Për atë shkak, me vetëndihmë të shoqatës anëtarëve të saj, gjatë kohës së pandemisë përmes aktiviteteve sociale-humanitare dhe lloje të tjera, tregojmë që solidariteti dhe reciprociteti janë prezent në shoqatat dhe njohuritë për komunikimin e

realizuar me ju, tregon që edhe në këtë situatë, ju shpërndani energji pozitive.

Numri i shfrytëzuesve të pensionit në Republikën sipas të dhënave të Fondit të SPIMV është 323.455 me gjendje shkurt 2020.

Fakt është që pensionet në Maqedoni paguhet rregullisht, ndërsa pensioni mesatar i paguar për shkurt 2020 është 15.298 denarë. Paga mesatare e të gjithë të punësuarve në vend, sipas të dhënave të Entit shtetëror për statistikë e paguar për janar 2020, është 27.570 denarë, ndërsa pjesëmarrja e pensionit mesatar të paguar në shkurt 2020 në raport me pagën mesatare të paguar në janar 2020 është 55,54%.

Ja edhe disa të dhëna të tjera.

	680 000	657.99
Sloveni	1 250 000	377.00
Kroaci	1 800 000	224.00
Serbi	323 455	248.00
Maqedoni	120 000	272.00

Grafiku e tregon numrin e pensionistëve në raport me numrin e të punësuarve në rajon. Ai raport, më i lartë është në Maqedoni dhe është 1:1.8.

Në disa vende, për shkak të pandemisë me Covid 19, qytetarët kanë marrë ndihmë financiare nga shteti. Në ato masa në mënyrë të ndryshme janë përfshirë edhe banorët më të moshuar, pensionistët.

Mali i Zi - Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i pensionistëve me pension më të ulët iu ka paguar ndihmë të njëhershme në të holla në shumën prej 50 euro.

Serbi - të gjithë pensionistëve iu dha nga 4000 dinarë (rreth 35 euro), ndërsa qyteti Beograd dhuroi 173 000 pako atyre me pensione më të ulëta.

Sloveni - pensionistët me pensione nën 700 euro do të marrin rreth 130 dhe 300 euro.

Kroaci - për Pashkë do të ndajë nga 100-500 kn (65-100 euro).

Nga të dhënat e theksuara në shtetet e përmendura, pensionet paguhet në shumë të drejtës së marrë, të ndihmuar me mjete shtesë dhe lloj tjetër ndihme. Në vendin tonë, shfrytëzuesve të pensionit në periudhën e deritanishme të pandemisë u ndihmojnë komuna të caktuara, Kryqi i Kuq dhe shoqatat e pensionistëve sipas mundësive të tyre. Në fund, edhe një herë apeloj dhe potencoj që ju si kryetarë të Shoqatave të ndihmoni të gjithë anëtarët e juaj pensionistë deri në respektimin e ardhshëm të të gjitha masave për mbrojtje si dhe gjetjen e mënyrave dhe mundësive si t'i ndihmojmë vetes në këto momente të vështira.

Stanka Trajkova,
kryetare e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë.

AKTIVITETET E SHP ÇAIR

Janë ndarë maska mbrojtëse

Duke patur parasysh gjendjen e jashtëzakonshme, ndërsa me qëllim të jepet mbështetje në uljen e rrezikut të shpërndarjes dhe infektimit, me dëshirë për zbutje të pasojave me Covid 19, luftë në të cilën gjithkush përfshihet aq sa din dhe mundet, nuk qëndroi e shurdhër as udhëheqësia pranë Shoqatës së pensionistëve Çair. Shoqata u përfshi në aksionin për ndihmë të anëtarëve të saj në parandalimin e përhapjes së koronavirusit, me çka, grupeve më të rrezikuara, të moshuarve dhe personave të lodhur, banorëve me sëmundje kronike të shtëpisë së pleqve në Fushë Topanë, iu dhanë 60 maska mbrojtëse me cilësi të lartë, të cilat do ta rrisin shkallën e ruajtjes së shëndetit të tyre, me çka, në mënyrë më praktike e treguan kujdesin për shëndetin anëtarëve të tyre.

Në këto ditë të vështira të pandemisë, kur virusi Covid 19 është prezent në vendin tonë dhe mbarë botën, ky gjest human dhe solidar i udhëheqësisë nga SHP Çair është për çdo lëvdatë. Kjo është një ndihmë modeste dhe ndoshita e vogël, por për pensionistët është e madhe.

"Duhet të kontribuojmë për uljen e përhapjes së koronavirusit. Për momentin kjo ndihmë më së shumti është e duhur për pensionistët. Prandaj, theksoj që duhet të respektohen rekomandimet për të mirën e të gjithëve, para se gjithash për të mirën e më të afërmeve. Duhet të ndihmojmë secili aq sa mundet, ndërsa ndihmojmë nëse i respektojmë masat dhe rekomandimet e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë dhe të Qeverisë së RMV. Apeloj deri te të gjithë pensionistët të qëndrojnë në shtëpi dhe të mos dalin pa nevojë", deklaroi koordinatori pranë SHP Çair, Todor Iliev. V. Paçemski

SHP TETOVË DHE GJENDJA E PANDEMISË

Pandemia me koronavirusin u bë edhe një sfidë për njerëzit humanitarë, kompanitë dhe asocionet tjera shoqërore. Shembujt për solidaritetin e vërtetuar për ndihmë, edhe njëherë dolën në pah, veçanërisht me dorën dhe ndihmën e ofruar, veçanërisht ndaj asaj kategorie, e cila më së shpeshti identifikohet si njerëzit nga gjenerata e tretë, ose ndaj më të moshuarve dhe të prekurve sociale, të cilët kanë nevojë më së shumti. Ky humanizëm, veçanërisht është për respekt sepse edhe donatorët janë në rrezik të ngjashëm nga Covid 19, ndërsa prapë se prapë dëshira e tyre për ndihmë është prezent. Gëzon fakti që në

Humanitarët vërtetojnë solidaritet

të gjitha mjediset e rajonit të Tetovës, krijohen lista për njerëzit e palëvizshëm dhe që janë në kujdes të askujt, të cilët më së shumti i godet pandemia.

Pa thirrje të veçantë, me vetë iniciativë, në Tetovë në javët e para të shpërndarjes së virusit të rrezikshëm për jetë, u paraqiten disa organizata dhe individë humanitarë, të cilët ofruan ndihmë. Ashtu, organizata joqeveritare "Thirrja e mirësisë" përmes kryetarit të saj Diturim Xheladini, dhuroi 1.000 pako me produkte ushqimore dhe 300 me produkte higjienike. OHB

"Kalliri i mirësisë" me aksion të ngjashëm, paralajmëron edhe rreth 500 pako. Halil Kastrati, humanist nga Kosova, ka siguruar 150 pako për pensionistët me të ardhura më të ulëta nga Komuna e Bogovinës. Ndihmë me 100 pako arriti edhe nga Shqipëria nga humanisti dhe teologu Elvis Naçi. Mevail Abdiu dhe Sreten Kocovski, të dytë persona të parë të organizatës joqeveritare "Rotari Klub" nga Tetova tashmë kanë siguruar 40 skafanderë, 200 maska dhe 100 palë syze, kryesisht të parapara për punonjësit shëndetësor ose

për kategorinë e policisë ose ushtrisë, të cilët janë të parët në radhë për ballafaqimin me virusin. Për familjet e kategorive më të rrezikuara dhe pensionistët me të ardhura të ulëta, pako me produkte higjienike dhe ushqimore ndau edhe kompania "Kiper".

Në Shoqatën e invalidëve të punës dhe shfrytëzuesve të pensionit invalidor informojnë që para pak ditësh rreth 100 pensionistëve iu është ndarë ndihmë e njëhershme në të holla. Kryetari Gido Bojçeski paralajmëron edhe ndihmë financiare shtesë, por tani

për tani nuk ka mundësi për mbajtjen e mbledhjes me organin kompetent në shoqatë në mënyrë që të silllet ai vendim.

Në Shoqatën e pensionistëve Tetovë, gjithashtu nuk është debatuar për intervenim financiar për pensionistët me të ardhura më të ulëta në familje, sepse nuk kanë mjete teknike për online takime, por për atë aksion do ta shfrytëzojnë mundësinë e parë. Në biseda të lira, anëtarët e kësaj shoqate konsiderojnë që SHP Tetovë atë duhet ta bëjë sa më shpejtë në këto kohëra të vështira për të gjithë, veçanërisht për të sëmurit dhe anëtarët e prekur social. G. Eftoski